



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-124

PËR NDRYSHIMIN DHE POTËSIMIN E LIGJIT PËR SHËNDETËSI

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Duke marrë parasysh nevojën për të ndryshuar ligjin në mënyrë që arrihet pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumentet tjerë relevantë,

Miratton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE POTËSIMIN E LIGJIT PËR SHËNDETËSI

Neni 1

Teksti i tërë pjesës hyrëse të Ligjit të zëvendësohet me formulimin në vijim:

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Me qëllim të vënies së bazës ligjore për rregullimin, përparimin dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore dhe kujdesin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës,

Neni 2

Në nenin 28 paragrafi 4 pika (b) plotësohet dhe riformulohet si vijon:

- a) Shëndetin publik, duke përfshirë edukimin dhe vaksinimin në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Në nenin 30 shtohen dy paragrafë të reja 30.3 dhe 30.4 të cilat kanë përmbajtjen në vijim:

30.3 Komuna e Mitrovicës së Veriut, Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Shtërpcës, do të kenë kompetenca vetanake për ofrimin e kujdesit shëndetësor dytësor, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, marrjen në punë, pagesën e rrogave, aftësimin e personelit shëndetësor dhe administratorëve të kujdesit shëndetësor, në pajtueshmëri me udhëzimet dhe standardet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

30.4 Në përputhshmëri me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale institucionet shëndetësore publike të nivelit dytësor kanë të drejtë të bashkëpunojnë me institucionet shëndetësore të komunave tjera brenda sferës së kompetencave të veta në fushën e kujdesit dytësor shëndetësor.

Neni 4

Në nenin 47 shtohet një paragraf i ri 47.3 i cili ka përmbajtjen në vijim:

47.3 Komuna e Mitrovicës së Veriut, Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Shtërpcës, vendosin për përmbushjen e kushteve për fillimin e punës së institucioneve shëndetësore të kujdesit dytësor në komunat përkatëse.

Neni 5

Në nenin 56 paragrafi 10 plotësohet dhe riformulohet si në vijim:

56.10 Procedurën rreth përgatitjes së planeve strategjike, afat-mesme dhe operative për të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor e siguron Ministria e Shëndetësisë, pa paragjykuar kompetencat e komunave sipas nenit 30.3 të këtij ligji.

Neni 6

Në nenin 57 shtohet një pikë e re (j) e cila ka përmbajtjen në vijim:

- j) Mjetet nga burimet financiare komunale të përcaktuara me Ligjin për financat e pushtetit lokal.

Neni 7

Neni 72 plotësohet dhe riformulohet si në vijim:

Licencimin dhe akreditimin e institucioneve shëndetësore e bën Ministria e Shëndetësisë në bazë të rregullativës ligjore nga neni 40.3 pa paragjykuar kompetencat e komunave sipas nenit 30.3 duke përjashtuar akreditimin.

Neni 8

Neni ekzistues 90 do të renditet si 90.1, ndërsa i shtohet edhe një paragrafë i ri 90.2 i cili ka përmbajtjen në vijim::

90.2 Regjistrimi dhe licencimi i punëtorëve shëndetësor në nivel vendi bëhet nga Ministria e Shëndetësisë, pa paragjykuar kompetencat e komunave sipas nenit 30.3 të këtij ligji.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-124
16 dhjetor 2008

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI